

VENDIM
Nr.419, datë 2.7.2004

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.653, DATË 21.11.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE
STRATEGJIKË, TË INTERESUAR PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË
ANONIME “ALBTELECOM””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të nenit 5 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fjalinë e parë të paragrafit të katërt të pikës 3 të vendimit nr.653, datë 21.11.2001 të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve “...të specializuar në fushën e telekomunikacioneve...” të bëhet kjo shtesë:

“...dhe të certifikuara në bazë të serisë së standardeve ISO 9 000 ose të sistemeve të njësuar me to.”.

2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano